

# Raport 3 Mujori për Investitorët dhe Publikun Q1 2019

**WVP**  
**FUND MANAGEMENT**  
**TIRANA SH.A.**

ARTON LENA  
CEO/CIO

KRISIAN ZAVALANI  
EQUITY SALES & TRADING /  
ASSISTANT TO THE CEO

## Tabela e Zhvillimeve

Hyrje .....	1
Perspektiva e Tregut.....	2
Analiza e Risqeve .....	3
Performanca, Statistika dhe Fakte .....	4
Përfundime, Disa Këshilla nga Ne për Ju. ....	5

# HYRJE

Të gjithë investitorëve,

Në mbyllje të 3 mujorit të parë të vitit 2019 ne, WVP FUND MANAGEMENT TIRANA po ju shkruajmë për t'ju raportuar mbi performancën dhe ecueshmerinë e fondit **WVP Top Invest**. Në këto muaj të parë ka pasur shumë zhvillime me interes dhe ecuria jonë ka qënë solide. Në faqet që vijojnë ju do të mund të shikoni më me detaje se si fondi ka menaxhuar asetet e tij dhe sa te aplikueshme dhe menaxhueshme ishin mundësitë dhe risqet e parashikuara ne Letren tonë Të Hapur për 2019. Ky raport ju kushtohet kryesisht investitorëve tanë por jep infarmacion edhe për individët, institucionet publike e private si dhe media të interesuara në veprimtarinë tonë.

Kompania tashmë ka shënuar vitin e parë të ciklit të saj në treg dhe për ne ky 3 muaj ishte akoma dhe me i vecantë pasi arritëm të realizonim diçka të pa dëgjuar më parë në fushën e investimeve në Shqipëri, ngritjen e një fondi që investon në aksione dhe do të vazhdojmë të punojmë drejt objektivave tona. Sfidat kanë qënë dhe vazhdojnë të jenë të shumta dhe ne nuk na ngelet gjë tjetër veçse t'ju falenderojmë të gjithë atyre që na dhanë besimin e tyre në këtë cikël të parë te inisiativës tonë.

Ngjarjet më e rëndësishme e këtij 3 mujori në tregjet financiare ishin rritja rekord e çmimeve të aksioneve dhe kthimi mbrapsht e një pjese të asaj të cilën ne e quajmë Yield Curve. Te dyja këto ngjarje janë e një rendësie shumë të madhe për fondin dhe performancën dhe politikat e tij. Gjithashtu ekonomia Shqiptare ka raportuar ngadalësim, një arsye më shumë për ju, investitorët, që të diversifikoni riskun e investimeve tuaja duke marrë pjesë në rritjen e ekonomisë botërore.

Raporti i mëposhtëm do të jetë i përmbledhur dhe solid në pikat më kryesore të vëmëndjes tonë rreth strategjive të fondit dhe ekonomisë botërore, faktorë këta që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën tonë.

# Perspektiva e Tregut

Në këto momente që shkruajmë ambienti investues në të cilin ndodhemi ka pësuar ndryshime shumë pozitive krahasuar me gjëndjen për të ciliën ju raportuam në fillim të vitit. Performanca e tregjeve botërore financiare ka qënë në një rritje konstante (me disa luhajtje të vogla) që prej datës 25 Dhjetor 2019 dhe sigurisht që fondi ka përfituar në mënyrë të konsiderueshme nga kjo rritje. Në letrën tonë vjetore shkruam se, *“Ju, Investitori duhet të përgatiteni për maturimin e ciklit rritës së ekonomisë botërore.”* Sot jemi të lumtur të rishkruajmë se ky cikël ende nuk duket drejt fundit të paktën edhe për 2-4 vitet e ardhëshme. Strategjia jonë vazhdon të mbetet e pandryshuar dhe shtrihet në arritjen e:

1. Likuiditetit
2. Cilësisë
3. Vlerës
4. Horizonit Afatëgjatë.

Siç edhe kemi përmendur në Letrën tonë Vjetore *“Objektivi jonë kryesor do të jetë arritja e planeve të përshkruara në prospektin tonë duke synuar gjithmonë në përfitime afatgjata dhe jo anasjelltas, ndërkohë duke minimizuar riskun sa të jetë e mundur. Ne jemi të besimit se kjo strategji do të arrijë me sukses t’u shërbejë mirë ju investitoreve teksa cikli maturohet.”* Në vijim të këtij cikli strategjia e **WVP Top Invest** ka rezultuar superiore në këtë 3 muor duke arritur rritjen më të lartë të vlerës Neto të Aseteve të fondit në 1 vjetorin tonë të parë në treg.

Risqet e pritura vazhdojnë të mbeten të njëjta si më parë tashmë duke paraqitur një nivel më të ulët pritshmërie. Do të përmendim specifikisht 4 risqe kryesore që ngelen në vëmëndjen tonë:

1. Yield Curve
2. Borxhi i Akumuluar i Korporatave
3. Normat e pritura të interesit bazë në Amerike dhe Europë
4. Ngadalësimi i ekonomisë botërore

Të gjithë këta faktorë do të analizohen në seksionin e mëposhtëm duke ju dhënë një ide më të qartë se çfarë të prisni në vijim dhe si të interpretoni të dhenat e tregjeve dhe ekonomisë botërore.

# Analiza e Risqeve

## 1. Yield Curve

Yield Curve perfaqëson kurben e obligacioneve të një kualiteti krediti (Credit Quality) të njëjtë por maturimi të ndryshëm. Historia ka treguar se është një nga parashikuesit më të mirë të ecurisë së ekonomisë botërore. Në një rrjedhë normale kurba është rritëse që do të thotë se obligacionet afatshkurtëra kanë një interes më të ulët se obligacionet afatgjata. Kjo gjë është logjike sepse një borxh afatgjatë mbart në vetvete risk më të lartë si psh. risku i inflacionit, risku i kthimit të principalit, risku i interesit, risku i kohës dhe risku i likuiditetit.

Historikisht kjo kurbë ka treguar perceptimin e tregut për ekonominë, specifikisht inflacionin. Në rast se pritshmëritë për inflacionin janë shumë të ulëta atëherë shanset janë që GDP-ja nuk po rritet mjaftueshëm ose dhe mund të ketë ngelur në vend apo dhe rënë. Nëse një situatë e tillë ndodh atëherë investitorët kërkojnë të blejnë obligacione afatgjata për të siguruar interesa më të larta për një periudhë afatgjatë pasi presin rënien e tyre për shkak të një ekonomie të dobët. Kur kjo gjë ndodh në masë çmimet e obligacioneve afatgjata rriten duke cuar në uljen e interesit në një shifër më të vogël se ajo e obligacioneve afatshkurtëra. Në këtë rast themi që kemi një kthim mbrapsht të Yield Curve. Kjo është ekzaktësisht ajo çfare ndodhi gjatë fundit të Marsit 2019:

### Inversion Accomplished

One of the most-watched U.S. yield curves drops below zero

✓ Yield spread between 3-month and 10-year Treasuries



Source: Bloomberg

Ky grafik paraqet diferencën e interesit midis Bonove 3 mujore te Qeverise Amerikane dhe Obligacioneve 10 vjeçare. Normalisht çdokush do të priste që interesat 10 vjeçare të jenë më të larta se ato 3 mujore por sic mund te shikoni ne rrathët e kuq 1 dhe 2 kjo gjë nuk ka ndodhur.

Imagjinojeni në këtë mënyre:

Sikur depozitat ne banke për 1 vit të paguanin më shumë interes se sa po ti linit në një depozite 5 vjeçare. Edhe pse duket e pa logjikshme tregu i obligacioneve funksionon në një mënyrë shumë më të komplikuar sesa depozitat dhe ideologjia e funksioni i tyre është jashtë fushës qëllimore të këtij raporti.

Siç mund ta shikoni hera e fundit që kjo gjë kishte ndodhur ishte diku tek 2 vjet para krizës botërore financiare në 2008. Kjo është arsyeja përse shumë investitorë i trëmben kthimit mbrapsh të kësaj kurbe pasi pothuajse përpara 80% të krizave që kanë nodhur kurba është kthyer mbrapsh. **Megjithatë parashikimi që kjo kurbë bën vonon deri në 2 vite pas kthimit të saj. Gjatë kësaj periudhe çmimet e aksioneve mund të vazhdojnë të rriten në ritme edhe me 20%.**

Në këto momente që shkruajmë jo vetëm që ky kthim nuk pritet të japë efekte të shpejta por ai është rirregulluar duke u ribërë pozitiv me **0.06%**. Ne momentin e kthimit të tij në fillim çmimet ranë ne mënyrë anormale brënda ditës por tashmë jo vetëm janë rikthyer aty ku ishin por edhe me lart.

## **2. Borxhi i Akumuluar i Korporatave, Normat e pritura të interesit bazë në Amerike dhe Europë, Ngadalësimi i ekonomisë botërore**

Risqet e tjera të shkruara më sipër janë më të vështirë për tu analizuar dhe shpjeguar pasi volumi është i madh dhe të dhënat shpesh herë janë të fshehta në natyrë dhe jo ekzakte. Ka shumë faktorë që ndikojnë por mund të themi se risku më kryesor është borxhi madh i akumuluar i korporatave të mëdha. Pas krizës botërore për vite të tëra interesat vazhdojnë të ngelen mjaft të ulta gjë që çoi në një kosto kredie më të lirë per kompanitë. Kjo bëri që bilancet e tyre të mbushen me borxhe dhe ekziston frika se nëse normat rriten ose ekonomia forcohet likuiditeti i tyre nuk do të mund ti përballojë interesat. Megjithatë për shkak se interesat janë ende shumë të ulëta edhe një avancim sado i vogel ekonomik mund të nxisi rritjen e normave bazë të interesit duke krijuar një ngërç per shkak se për te rregulluar situatën duhen ulur normat përseri por ato janë që tani shumë të uëta. Kjo gjë u pa në praktike kur Federal Reserve FED (Banka Qëndrore Amerikane) rriti vitin e kaluar interesat dhe tregjet menjëherë reaguan keq duke rënë. Në 2019 nuk pritet një rritje e mëtejshme.

Kjo gjë na tregon dy anë të medaljes dhe shpjegon ngërçin për të cilin folëm më lartë:

1. Nëse ekonomia rritet dhe normat e interesit rriten kompanitë me borxhe rrezikojnë likuiditetin dhe falimentin. Kjo sjell një krizë financiare më pas në botë.
2. Nëse ekonomia rritet dhe normat nuk rriten atëherë kjo sjell inflacion me të lartë sesa duhet dhe parasë i bie vlera ndërkohë që çmimet rriten. Zakonisht kur kjo ndodh rrogat dhe pagat nuk rriten me nivelin e inflacionit gjë që i bën njerzit më të varfër automatikisht. Rrjedhimisht kjo çon në një krizë botërore për shkak të konsumit.
3. Nëse nuk kemi rritje të ekonomisë botërore automatikisht hyjmë në reçesion dhe përsëri tregjet bien dhe konsumi ulet duke bërë që disa kompani të mbyllen për shkak të uljes së xhiros por edhe sepse tashmë edhe me normat e ulëta nuk mund të paguajnë më interesat e kredive duke na kthyer përsëri tek pika 1 dhe përfundimi është i njëjtë.

Pra siç e shikoni ky risk është mjaft serioz sepse në këtë rast edhe sikur ekonomia botërore të shkojë mirë dhe rritet edhe sikur te qëndrojë në vend ose të bjerë rrjedhimisht përsëri çon në një krizë. Siç thotë populli situata bëhet "As mish As peshk, As ashtu As kështu." Emri i kësaj gjëndje quhet një Kurth Likuiditeti dhe e vështirëson shumë punën e Bankave Qëndrore për ta rimëkmbur ekonominë.

Për momentin ne nuk besojmë se ky risk do të materializohet së shpejti. Siç u përmend nëse tregjet do ta ndihnin afër këtë rrezik do të ishte thelluar kthimi i kurbës së obligacioneve për shkak se shume faktorë të tjerë që analizohen nga investitorët për çdo krize të mundshme reflektohen aty.

Ndërkohë tregjet financiare vazhdojnë të rriten me ritme shumë të mira duke thyer rekorde ose kapur shifra rritjeje që nuk ishin parë prej vitesh ose dekadash. Momentalisht jemi shumë afër arritjes së nivelit më të lartë historik të tregjeve financiare dhe pritet që çmimet të rriten dhe arrijnë vlerën më të lartë gjatë gjithë historisë tonë së shpejti. Megjithatë kjo gjë nuk duhet t'ju bejë më optimist se ç'duhet pasi luhatshmëritë në bursa janë të sigurt. Ajo çka duhet t'ju entuziazmojë është se në afatgjatë me shumë siguri do të përfitoni nga këto tregje dhe kapitalet tuaja të investuara do të thyejnë rekordet e balancave në të cilat janë tani.

### 3. Ekonomia Shqiptare fillon ngadalësimin

"Ekonomia shqiptare do të rritet më pak për dy vitet në vazhdim. Në raportin ekonomik për Ballkanin Perëndimor, Banka Botërore vlerëson se rënia ekonomike do të bjerë në 3.8% këtë vit dhe 3.6% vitin e ardhshëm. Madje, rreziqet për një rritje edhe më të dobët janë të larta, të lidhura si me faktorë të brendshëm, ashtu edhe me të jashtëm. Edhe në këndvështrimin e Bankës Botërore, pasiguria politike po bëhet një faktor që rrezikon gjithnjë e më shumë ekonominë dhe vazhdimin e reformave. Në kushtet kur rreziqet po rriten, Banka Botërore këmbëngul që Shqipëria të vazhdojë reformat që do të rrisin besimin e investitorëve dhe do të krijojnë vende pune në sektorin privat. Në pesë vitet e fundit, Shqipëria ka njohur një përmirësim të ndjeshëm të rritjes ekonomike, por në një pjesë të madhe kjo trajektore ka qenë e lidhur me faktorë të përkohshëm. Ndër to kanë qenë shlyerja e sasive të mëdha të detyrimeve të prapambetura buxhetore, projektet e mëdha të investimeve të huaja apo edhe prodhimi i lartë i energjisë elektrike falë kushteve të favorshme të motit, siç ndodhi vitin e kaluar. Në mungesë të faktorëve të këtij lloji, ekonomia shqiptare ende duket se nuk ka konsoliduar burime më të qëndrueshme të rritjes, megjithë sinjalet pozitive nga sektori i turizmit." (SCAN Media, 4/2019).

Ky është një risk per JU, Investitorë! Kursimet e Shqiptarëve ndodhen 99% brënda vëndit ndaj investimi në kuota në fonde që investojnë jashtë vëndit do të diversifikonte riskun tuaj.

# Performanca, Statistika dhe Fakte

Në këtë 3 mujor të parë **WVP Top Invest** ka arritur një performancë të shkëlqyer duke realizuar një fitim **NETO** për investitorët në vlerën e **13.96%**. Deri më tani ky është fitimi më i lartë në historikun e shkurtër 1 vjeçar të WVP Top Invest. Rikuperimi i tregjeve financiare pati një ndikim shumë pozitiv dhe në këto momente që shkruajmë performanca vazhdon të forcohet. Gjithashtu fondi arriti të kalojë Benchmark-un e tij me **0.92%** duke kaluar në performancë tregjet botërore të cilave ne ju bazohemi. Benchmark llogaritet si një miks i tregjeve Europiane dhe Amerikane për shkak se këto janë kontinentet ku fondi ka prezencë në investime. Në rast se kthimi i fondit është më i lartë se i Benchmark kjo do të thotë që ne i kemi kaluar në performancë tregjet në tërësi në të cilat ne investojmë, pra nëse ju do të investonit njëkohësisht individualisht dhe do të blinit çdo kompani të mundëshme të cilat ekzistojnë brenda universit në të cilin fondi selekton do të kishit një fitim më të ulët. Kjo tregon që fondi ka përzgjedhur kompani të cilat kanë performuar më mirë se mesatarja e tregut në tërësi.

## Performance

	WVP Top Invest	WVP Benchmark **
1M	0.93%	2.51%
3M	13.96%	13.04%
6M	-0.76%	1.41%
1 Year	2.31%	8.97%
YTD	13.96%	13.04%

Vlera NETO e aseteve dhe kuota e fondit për datën **31.03.2019** qëndrojnë në vlerën e **92.979.731,04 Lekë** dhe **1.023,2069 Lekë/Kuotë**.

Fondi arriti një devijim standart prej **11.94%** dhe ju atashua nota e riskut **5 (Risk Mesatar)**. Për më në detaje bashkëngjitur të dhënat:


## Information about the Fund

Name of the Fund	WVP Top Invest
Inception Date	29/03/2018
Currency of the shares	LEK
Net value	<b>92.979.731,04</b>
Unit Price	<b>1.023,2069</b>
Fund Type	Accumulation
Custody Bank	First Investment Bank Albania
Subcustody Bank	First Investment Bank Bulgaria
	Clearstream
Benchmark	WVP Benchmark
Standard deviation	11.94%
Risk class	5




Pas rënies së performancës në fundin e vitit 2018 kuota po ngjitet drejt një rekordi të ri historik. Ne presim që brënda muajit prill kuota të kapë vlerën e të paktën **1040 Lekë**. Më poshtë gjeni Historikun e Kuotës deri më **31.03.2109**:

### Unit price



Përsa i përket ekspozimit gjeografik investimet tona vazhdojnë të jenë më të përqëndruara në Amerikë, Gjermani dhe Francë, me pjesën tjetër të alokuar në shtete të tjera të zhvilluara Europiane. Më poshtë gjeni të dhënat e detajuara mbi Ekspozimin Gjeografik të Top Invest:


### Geographic Exposure



Këto pesha janë subjekt i ndryshimeve në bazë të politikave investuese referuar prospektit.



**WVP Top Invest** pas rënies në fund të vitit 2018 vazhdon të përqëndrojë pjesën më të madhe të investimeve në industrinë e lëndëve të konsumit të përditshëm për shkak të qëndrueshmërisë më të lartë që këto kompani kanë në bursa. Pas tyre ekspozimet tona më të mëdha janë në Shërbimet Financiare dhe Kompanitë Framaceutike & Biotech. Këto të fundit kanë luhatshmëri më të lartë por dhe fitime të pritura më të mëdha dhe ne i kemi kombinuar me industrinë mbrojtëse për të pasur një kosto/benefit të pëlqyeshëm dhe në mënyrë që të menaxhohen risqet por në të njëjtën kohë duke sjellë fitime më të larta se mesatarja. Më poshtë gjeni të detajuar ekspozimin e **WVP Top Invest** në industrinë përkatëse:

### Sectoral Exposure



Në modelet tona të riskut fondi rezultonte i nën-investuar në tregjet Amerikane. Gjate 3 mujorit të parë të Vitit 2019 janë ndërmarë hapat e duhura për të përshtatur investimet tona brënda modeleve të riskut dhe janë shtuar investime në tregjet Amerikane. Asgje nuk ndryshon në strategjinë tonë dhe për momentin nuk presim ndonjë investim i cili mund ti ndryshojë këto pesha në një të ardhme të afërt. Fondi pret rritjen e depozitave për të bërë lëvizje të mëtejshme.

Përsa i përket riskut monetar më datë **31.03.2019** një përçindje e papërfillshme ndodhej në llogaritë tona në Lekë dhe gjithë asetet ishin në valutë. Këto vlera llogariten pas aseteve Cash të lëna mënjanë për detyrimet afatshkurtëra të fondit. Kjo do të thotë se fondi ka nevojë për kapital shtesë për të vazhduar të investojë në kompani të tjera apo për të rritur zotërimin në kompani ekzistuese. Arsyeja pse fondi nuk ka likuiditet përveç atij të llogaritur për detyrimet është sepse kemi bërë dy investime në dy kompani të reja në Amerikë të cilat do të mund ti shihni ne vijim të këtij raporti. Më poshtë gjeni Ekspozimin Monetar të **WVP Top Invest** dhe alokimin e Instrumenteve Monetare dhe Financiare:

**Exposure by Type of Instrument****Currency Exposure**

Gjatë këtij 3 mujori në portofolin tonë janë shtuar dy kompani të reja në të cilat fondi ka investuar. Ato janë:

1. **Intercontinental Exchange Inc. (NYSE: ICE)**
2. **Berkshire Hathaway Inc. (NYSE: BRK.B)**

Të dyja kompanitë tregëtohen në bursën e New-York-ut me simbolet e lartëpërmëndura. **Intercontinental Exchange** ka në pronësi bursa në të gjithë botën përfshirë vetë **NYSE** (Bursën e New York ku vetë ajo kuotohet). Të ardhurat e kompanisë janë shumë stabël dhe relativisht të parashikueshme pasi çdo blerje ose shitje që ndodh në bursat të cilat kompania zotëron përkthehet në një të ardhur për kompaninë.

**Bershire Hathaway** është kompania e 5-të më e madhe në planet për nga vlera. Ajo menaxhohet nga **Warren Buffet**, i cilësuar si investitori më i mirë i tregjeve financiare që njerëzimi ka hasur deri më sot. Fondi ka investuar në Aksione të Klasit B. Kompania momentalisht mban rreth **100 Bilion \$** vetëm Cash pasi ka aq shumë para sa nuk po gjen mënyrën e duhur se si ti investojë ende për shkak të situatave të lëkundëshme që tregu pësoi.

## Portofoli i Kompanive të WVP Top Invest

No.	Name Of The Company	ISIN	Currency	No. Of Shares	Price	Exchange Rate	Value in ALL	% NAV
1	Procter & Gamble Co/The	US7427181091	USD	330	104.0400	111.670000	3,833,988.44	4.12%
2	Diageo PLC	GB0002374006	GBP	800	32.3400	145.440000	3,762,823.68	4.05%
3	Nestle	CH0038863350	CHF	328	94.9000	112.130000	3,490,292.94	3.75%
4	Pfizer Inc	US7170811035	USD	735	42.4700	111.670000	3,485,829.30	3.75%
5	Walmart Inc	US9311421039	USD	295	97.5200	111.670000	3,212,567.23	3.46%
6	BOEING	US0970231058	USD	75	381.4200	111.670000	3,194,487.86	3.44%
7	Apple Inc	US0378331005	USD	150	189.9400	111.670000	3,181,589.97	3.42%
8	Merck KGaA	DE0006599905	EUR	250	101.3000	125.340000	3,174,235.50	3.41%
9	EXXON MOBIL CORP	US30231G1022	USD	350	80.7900	111.670000	3,157,636.76	3.40%
10	SANOFI SA	FR0000120578	EUR	320	78.6900	125.340000	3,156,161.47	3.39%
11	Roche Holding AG	CH0012032048	CHF	100	274.2000	112.130000	3,074,604.60	3.31%
12	Facebook Inc	US30303M1027	USD	160	166.6600	111.670000	2,977,747.55	3.20%
13	Unilever NV	NL0000009355	EUR	455	51.8700	125.340000	2,958,130.54	3.18%
14	Zurich Insurance Group AG	CH0011075394	CHF	80	329.5000	112.130000	2,955,746.80	3.18%
15	HeidelbergCement AG	DE0006047004	EUR	360	63.9800	125.340000	2,886,931.15	3.10%
16	UNITED TECHNOLOGIES CORP	US9130171096	USD	200	128.9100	111.670000	2,879,075.94	3.10%
17	Royal Dutch Shell PLC	GB00B03MLX29	EUR	820	27.9700	125.340000	2,874,723.04	3.09%
18	Allianz SE	DE0008404005	EUR	115	198.0400	125.340000	2,854,568.36	3.07%
19	TOTAL SA	FR0000120271	EUR	455	49.5200	125.340000	2,824,110.74	3.04%
20	Lloyds Banking Group PLC	GB0008706128	GBP	27,850	0.6700	145.440000	2,713,837.68	2.92%
21	AXA SA	FR000120628	EUR	965	22.4200	125.340000	2,711,768.50	2.92%
22	Deutsche Post AG	DE0005552004	EUR	690	28.9800	125.340000	2,506,323.71	2.70%
23	Siemens AG	DE0007236101	EUR	200	95.8300	125.340000	2,402,266.44	2.58%
24	Volkswagen Ag	DE0007664039	EUR	135	140.3000	125.340000	2,374,002.27	2.55%
25	Henkel AG & Co KGaA	DE0006048432	EUR	190	90.9400	125.340000	2,165,699.72	2.33%
26	BASF SE	DE000BASF111	EUR	260	65.5000	125.340000	2,134,540.20	2.30%
27	Fresenius SE & Co KGaA	DE0005785604	EUR	340	49.6200	125.340000	2,114,586.07	2.27%
28	ING Groep NV	NL0011821202	EUR	1,530	10.7720	125.340000	2,065,748.59	2.22%
29	Telefonica SA	ES0178430E18	EUR	2,200	7.4780	125.340000	2,062,043.54	2.22%
30	Bayerische Motoren Werke AG	DE0005190003	EUR	235	68.4700	125.340000	2,016,777.00	2.17%
31	Intercontinental Exchange Inc	US45866F1049	USD	235	76.1200	111.670000	1,997,575.29	2.15%
32	Berkshire Hathaway Inc	US0846707026	USD	88	200.8400	111.670000	1,973,646.65	2.12%
33	Daimler AG	DE0007100000	EUR	300	52.1600	125.340000	1,961,320.32	2.11%
34	BNP Paribas SA	FR0000131104	EUR	345	42.6100	125.340000	1,842,554.40	1.98%

Fondi zotëron 34 kompani dhe nuk ka në planet e tij afatshkurtëra të shesë asnji nga pozicionet e tij në kushte tregu normale.

# Përfundime, Disa këshilla nga Ne për Ju...

Ashtu si në raportin tonë të letrës vjetore po e përmbyllim këtë raport duke ju siguruar edhe njëherë se:

Në të gjithë historinë e tregjeve financiare 3 gjëra janë gjithmonë të sigurta;

1. Tregjet do të kenë **GJITHMONË** luhatshmëri
2. Në afatgjatë tregjet **GJITHMONË** rriten sepse ekonomia botërore është vazhdimisht në rritje
3. Gjatë periudhave të vështira frika është **GJITHMONË** ngjitetëse;

Siç tashmë dhe faktet tregojnë luhatshmëria është e dukshme. Nga një performancë ulët në fund të 2018 tashmë investitorët shohin fitime prej **13.96%** në vetëm 3 muaj. Sigurisht në afatgjatë fondi pret vetëm rritje por duke pasur luhatshmëri her pas here të cilat janë normale.

## Investitorët KUJDES!

Ky seksion përfundimtar ju dedikohet specifikisht ju. Gjatë periudhës Tetor 2018-Mars 2019 siç e shikoni shumë ndryshime ndodhën. Ne duam t'ju kushtojmë pak nga koha jonë për t'ju dhënë këshillën më të vlefshme:

**“ Gjithmonë investoni periodikisht dhe rregullisht. Nuk ka rëndësi nëse keni investime të medha apo të vogla. Ju duhet të investoni optimalisht çdo muaj për të përfituar blerjen e kuotave me çmim mesatar. Ne nuk këshillojmë të investoni të gjitha paratë tuaja menjëherë. Investitorët të cilët nuk investuan nga Dhjetori 2018-Mars 2019 humbën rreth 20% rritje të kapitalit të tyre. Gjithashtu ata që pësuan rënie të investimit në fund të 2018 jo vetëm që i rikuperuan humbjet por arritën të blejnë kuota me çmime SHUMË të lira krahasuar me sot. Mos u përpiqni të parashikoni uljet dhe ngritjet e tregut sepse është e pamundur. Askush nuk mund të gjejë kohën perfekte për të investuar. Na besoni në këtë rrugëtim dhe na lejoni t'ju shërbejmë sa më mire”**

**Ju Faleminderit!!!**